



**Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDARYSHE**

PROGRAMI I PRAKTIKANTËVE/PRAKTIKANTEVE

THIRRJE PËR APLIKIM

Për punë praktike gjashtë mujore në EC Ma Ndryshe (dy pozita)

EC ka themeluar Programin e Praktikantëve/Praktikantëve me kohëzgjatje gjashtë muaj dhe ofron dy pozita për punë praktike në kuadër të aktiviteteve të organizatës. Programi është i hapur për studentët/studentet e Universiteteve në Prizren (të gjitha drejtimet), me banim të përhershëm në komunën e Prizrenit, të cilët/cilat janë të interesuar/a për të marrë njohuri dhe përvoja të reja dhe kontribuar në punën e organizatës.

Përshkrimi i punës praktike

Praktikantët/praktikantet e zgjedhur/a do të jenë pjesë e rregullt e stafit dhe punës së organizatës dhe gjatë gjashtë muajve të angazhimit, ata/ato do të:

- Punojnë me orar të shkurtuar (deri në 4 orë në ditë),
- Marrin një kompensim simbolik financiar në baza mujore,
- Asistojnë në realizimin e aktiviteteve brenda projekteve dhe iniciativave ekzistuese,
- Aftësohen në menaxhim dhe në temat e ekspertizës (urbanizmi, trashëgimia kulturore, transparenca, mobilizimi i komunitetit)
- Përfitojnë nga skema e zhvillimit të kapaciteteve brenda dhe jashtë Kosovës (trajnime, punëtori, Shkolla, vizita studimore)
- Konsiderohen për angazhim si staf i rregullt i organizatës në rast të performansës së mirë gjatë periudhës së punës praktike.

Gjatë angazhimit të tyre, praktikantët/praktikantet do të mbikëqyren nga stafi menaxherial i organizatës dhe do t'i nënshtrohen vlerësimit mujor të punës.

Kohëzgjatja e praktikës

Një cikël i punës praktike zgjat gjashtë muaj dhe me mundësi vazhdimi edhe për tre deri gjashtë muaj shtesë. Për secilin cikël gjashtë mujor të punës praktike do të përzgjedhen deri në dy praktikantë/praktikante që studiojnë në Universitetet e Prizrenit. Pas përfundimit të programit, praktikantët/praktikantet do të pajisen me dëshmi përkatëse për pjesëmarrje në këtë program.

Orari i punës dhe të drejtat e përfitimit

Praktikantët/praktikantet do të jenë të vendosur/a në zyrën e EC në Prizren dhe do të punojnë me orar të përgjysmuar, çdo ditë pune deri në katër orë në ditë. Pjesë e këtij orari të angazhimit, përveç punës në zyrën e organizatës, do të jetë edhe angazhimi në terren, për shkak të natyrës së punës komunitare që realizon organizata. Praktikantëve/praktikanteve, përveç kompensimit simbolik financiar në baza mujore dhe skemës për zhvillimin e kapaciteteve, do t'u sigurohen edhe të gjitha të drejtat e garantuara me Ligjin e Punës të Republikës së Kosovës.

Kriteret minimale

Për t'u kualifikuar për programin e praktikantëve/praktikanteve, kandidati/kandidatja duhet t'i plotësojë këto kushte:

- 18 vjeçar/e ose mbi këtë moshë,
- Student/studente në ndonjërin Universitet të Prizrenit,
- Me banim të përhershëm në komunën e Prizrenit,
- Aftësi minimale në menaxhim organizativ,
- Njohje të gjuhëve lokale të Prizrenit dhe të gjuhës angleze (kriter joobligativ),
- Shkathtësi në përdorimin e programeve kompjuterike dhe mediave sociale,
- I gatshëm / E gatshme për të filluar punën praktike gjatë pjesës së dytë të Shkurtit 2018.

Aplikoni

Për të aplikuar, ju lutem dërgoni CV-në tuaj dhe plotësoni formën e aplikimit që gjendet në web-faqen e organizatës www.ecmandryshe.org, brenda linkut Konkurs. Formën e plotësuar duhet të dërgoni në adresën info@ecmandryshe.org, me subjekt "Aplikim për Programin e Praktikës". Afati i fundit për aplikim është deri më 4 shkurt 2018.